

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                          |
|---------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Atentati në Athinë ku u plagos 10-vjeçarja shqiptare, urdhri dyshohet se erdhi nga i burgosuri “i famshë m” Klod Lekocaj |
| ADRESA  | https://versus.al/aktualitet/i-ne-athine-ku-u-plagos-10-vjecarja-shqiptare-urdhri-dyshohet--i47184                       |
| BURIMI  | versus.al                                                                                                                |
| GJENDJA | online                                                                                                                   |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 26 shtator 2026, 11:03:31 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 10:43:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 086ad135a1eb07ba8e73317b3695157b9d379b9f5197ea722de581885aa012c9 |
| TEKSTI     | df8e25dafc0ec1a9e3d55e3e3e67de884cf9c37d594d6568694b6ad6c4d16772 |
| PAMJA      | 4eff07b21ee074a06e2d82d1cf5d3b690f93bff5c557034705072ef7ee283058 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 72adb9038ec9a4b75025354425cc84c75b0310cc67fde5a333bbedf959883ded                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 2f94de55f91080d406fb9f0e4354ffa5a46214db9e0928186c4866f36bf6cd6f                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.


<https://scan.stamles.eu/verify/72adb9038ec9a4b75025354425cc84c75b0310cc67fde5a333bbedf959883ded>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





AKTUALITET

## SPAK operacion, goditet një grup kriminal i trafikut të drogës! (VIDEO)

26 Shtator 2026, 10:39

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

- 
- 
- 
- 
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZINë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

Kërko

- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZINë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

Created and monetized by  
AKTUALITET / 26 Shtator 2026, 12:43

## Atentati në Athinë ku u plagos 10-vjeçarja shqiptare, urdhri dyshohet se erdhi nga i burgosuri “i famshëm” Klod Lekocaj

Sipas të dhënave paraprake, në automjet ndodheshin katër persona, të cilët hapën zjarr pa zbritur prej tij dhe u larguan menjëherë. Në lokal ndodheshin edhe rreth dhjetë klientë.



Shkruar nga Veritas



Një vajzë 10-vjeçare me origjinë shqiptare mbeti e plagosur gjatë një sulmi me armë ndaj lokalit të babait të saj në lagjen Agios Panteleimonas të Athinës.



### **Të shtëna drejt një kafeneje në Athinë, plagoset vajza 10-vjeçare shqiptare**

26 Shtator, 08:16

E mitura ndodhej brenda kafenesë kur persona që lëviznin me automjetet qëlluan drejt fasadës.

Babai i vajzës është identifikuar si Denis Luli, 30 vjeç.

Sipas të dhënave paraprake, në automjetet ndodheshin katër persona, të cilët hapën zjarr pa zbritur prej tij dhe u larguan menjëherë. Në lokal ndodheshin edhe rreth dhjetë klientë.

Vajza u plagos në këmbë dhe u dërgua në spital.

Jeta e saj nuk është në rrezik. Autoritetet greke po hetojnë për të përcaktuar kush ishte shënjestra e sulmit dhe çfarë konflikti mund të fshihet pas tij.

Një nga dyshimet e ngritura gjatë hetimeve të para është se porosia për atentatin ka ardhur nga burgu, nga Klodian Lekocaj.

Kjo pistë nuk është konfirmuar zyrtarisht dhe deri tani nuk janë bërë të ditura prova që e lidhin atë me sulmin ndaj lokalit.

Kush është Klodian Lekocaj?

Klod Cara, i njohur edhe si Klodian Lekocaj, është një emër i përmendur prej vitesh në kronikën kriminale greke. Mediat në Greqi e kanë cilësuar si drejtues të së ashtuquajturës "Mafia e Burgjeve", ndërsa ai vetë i ka mohuar publikisht akuzat, duke e quajtur veten të pafajshëm.

Emri i tij është shfaqur në hetime për vrasje, tentativa vrasjeje dhe veprimtari të tjera kriminale. Në vitin 2022, pas arrestimit në Athinë të Viktor Çalës dhe Andi Beqirit, Çala deklaroi se ishte urdhëruar nga Lekocaj të vraste një shtetas grek për shkak të një konflikti të lidhur me trafikun e drogës.

Bëhet fjalë për një pretendim të dhënë gjatë hetimit, jo për një përfundim gjyqësor mbi përgjegjësinë e Lekocajt.

Lekocaj është përmendur gjithashtu në çështje që lidhen me vrasjen e avokatit grek Mixalis Zafiropoulos dhe me ngjarje të rënda brenda burgjeve greke.

Sipas raportimeve të mëparshme, ndaj tij janë ngritur akuza edhe për gjobëvënie dhe porositje atentatesh. Ai i ka kundërshtuar akuzat ndaj tij.

Në prill të vitit 2025, emri i Lekocajt u lidh me hetimet për atentatin ndaj dy shqiptarëve, Kristjanis Stefa dhe Florian Bajraktari, të ndodhur në shtator 2024.

Po atë vit, ai u përfshi në një incident në burgun e Korydhalosit, ku, sipas raportimeve, dy gardianë u mbajtën peng me thikë.

Për sulmin e fundit në Athinë, hetimi mbetet i hapur. Policia po kërkon të identifikojë personat që qëlluan nga automjeti dhe të verifikojë dyshimin se urdhri për atentatin është dhënë nga brenda burgut./Versus.al

Tags:

[denis luli](#) [klodian lekocaj](#)

Poll





AKTUALITET

**FOTO/ Shembja e godinës në Athinë, dy shqiptarë, motër e vëlla, mes viktimave**

26 Shtator 2026, 11:59

^ekstrakti^



AKTUALITET

**Kush është Bledar Cafi? Nga dënimi në Itali te arrestimi në operacionin “Muri i Lartë”**

26 Shtator 2026, 11:25

^ekstrakti^



AKTUALITET

**VIDEO/ Pas tre vitesh mungesë, SHBA-ja rikthen ambasadorin në Tiranë: Wendt mbërrin në Pallatin e Brigadave**

26 Shtator 2026, 11:12

^ekstrakti^



AKTUALITET

**SPAK operacion. goditet një grup kriminal i trafikut të drogës! (VIDEO)**

26 Shtator 2026, 10:39

^ekstrakti^





AKTUALITET

**EMRI/ Vodhi një automjet dhe përplasi katër makina teksa tentonte t'i shpëtonte policisë, arrestohet 30-vjeçari në Durrës**

26 Shtator 2026, 10:27

^ekstrakti^



AKTUALITET

**“Taksat mblidhen në Ksamil, por nuk na kthehen në investime”/ Banorët kërkojnë “divorcin” nga Saranda**

26 Shtator 2026, 10:19

^ekstrakti^



AKTUALITET

**Ndeshja Shqipëri-Bjellorusi, policia njofton planin e masave! Ja çfarë u kërkohet tifozëve**

26 Shtator 2026, 09:11

^ekstrakti^



**Eric Wendt nis misionin si ambasador i SHBA-së në Shqipëri, sot dorëzon letrat kredenciale te Presidenti Bega**

26 Shtator 2026, 08:28

^ekstrakti^

**Të fundit**



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.